

SUKSESI MBAN

TË GJITHË JEMI TË BARABARTË



EMRIN TONË

ELEMENTET E DEMOKRACISË

JAKUB (10), MENDIM (10), LORETA (10), ORGES (10), OMAR (10), MEDINA (11), ANDINA (10)


Shoqëria në demokraci

Fjala e popullit është e para dhe kryesorja në demokraci. Nërsa, vet fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratos“ që do të thotë qeverisje.

Demokracia u shfaq në kryeqytetin e Greqisë, në Athinë. Atëherë në Athinë, vetëm njerëzit e pasur mund ta qeverisnin vendin, kjo ka ndodhur në vitin 507 para erës sonë. Tash, në shtetet demokratike populli është i lirë të bëj ndryshime në shoqëri. Disa nga elementet e demokracisë janë: liria, të drejtat e barabarta, toleranca etj. Grupi ynë ka një mesazh për ju lexues: respektojeni njëri-tjetrin, keni tolerancë dhe punoni për të mirën e vendit.



Fëmijët gazetarë



Njëra nga mënyrat e numërimit të votave



Votimi i përfaqësuesve



E drejta e shkollimit në demokraci



Vota bën ndryshimin

ZGJEDHJET NA OFROJNË NJË JETË MË TË MIRË

ALBIONI (10), ENES (10), FIONA (10), HASIME (10), LEART (10), RIJAD (10), VESA (10)



Rëndësia e zgjedhjeve

A thua sa njerëz në ditë i mendojnë zgjedhjet dhe rëndësinë e tyre? Ne mendojmë që ashtu sikurse ne, edhe shumë njerëz të tjerë janë të interesuar të dijnë më shumë për zgjedhjet. Për këtë arsye, ne jemi munduar që ato që i mësuam sot, t'i transmetojmë edhe tek ju të dashur lexues. Në këtë artikull do të informoheni më shumë rreth zgjedhjeve dhe rëndësisë së tyre. Zgjedhjet janë shprehje të lira, sepse çdo njeri ka të drejtën të zgjedh dhe po ashtu të votoj për atë që mendon që është më i miri, si dhe i cili do ta përfaqësojë në mënyrën më të mirë.

Zgjedhjet janë elementi i parë për një jetë të mirë në një vend demokratik. Dikush nga ju mund t'i parashtrij vetes pyetjen se pse zgjedhjet janë elementi i parë. Janë të tilla sepse përmes zgjedhjeve ne e përcaktojmë jo vetëm të ardhmen tonë si individ, por po ashtu edhe të ardhmen e vendit tonë. Pra, me anë të zgje-

dhjeve ne e shprehim të drejtën tonë, që është e drejta e votës. Po themi të drejtën tonë, por ju të dashur lexues, besoj se veçse e dini se ne këtë të drejtë e fitojmë atëherë kur arrijmë moshën 18 vjeçare. Sepse në këtë periudhë ne jemi më të vetëdijshëm për veten dhe jetën tonë. Gjithashtu, jemi edhe më të pjekur përse i përket asaj se kë duhet të zgjedhim si përfaqësues. Kur ta arrijmë këtë moshë ne kemi të drejtë të votojmë në zgjedhjet lokale dhe qendrore.


Në zgjedhjet lokale ne votojmë për kryetarin e komunës dhe për asambleistët. Kurse, në zgjedhjet qendrore ne votojmë kandidatët për deputet. Zgjedhjet janë shumë të rëndësishme për një të ardhme më të mirë dhe për një vend më demokratik. Nëse përfaqësuesit tanë nuk janë të përpiktë dhe të afërt me ne, vështirë që do t'i fitojnë zgjedhjet e ardhshme. Zgjedhjet jo vetëm që janë të rëndësishme për ne, por për të gjithë.



E drejta e votës



Gazetarët e artikullit



Ne e duam librin. Nga libri fitojmë njohuri dhe dituri



Ne zgjedhim çdo ditë në jetën tonë të përditshme



Mbi moshën 18 vjeçare të gjithë kemi të drejtën e votës



Deputetët janë përfaqësuesit tanë




Kuvendi, shtëpia jonë



Vota jonë, ndryshim i përbashkët

KUVENDI DHE QYTETARËT

ELTON (10), ALMIRA (11), MARIGONA (10), URIM (11), FITIM (10), SALIH (10), ANESA (10), ELENA (10)



Ne sapo e përfunduar diskutimin në grupin tonë. Tema jonë është Kuvendi. Ju ftojmë të lexoni artikullin më poshtë

Dëshironi të mësoni më shumë për Kuvendin e Kosovës? Dëshironi të dini se çfarë funksione apo detyra ka Kuvendi në vendin tonë? Atëherë lexojeni këtë artikull për t'u informuar më shumë rreth kësaj teme.



Kuvendi apo ndryshe Parlamenti, është institucioni më i lartë demokratik i një vendi. Në Kuvend bisedohet për tema shumë të rëndësishme. Për këtë arsye, mbledhjet që mbahen nga deputetët, ne i shohim përmes televizionit.

Të gjitha temat që fliten në Kuvend kanë qëllim që të përmirësojnë jetesën e qytetarëve, ku nënkuptohet jeta jonë. Kjo për shkak se ne qytetarët i zgjedhim deputetët tanë, me anë të votës.

Pra, përgjegjësi e tyre është mirëqenia jonë, sepse ata

janë përfaqësuesit tanë. Në Kuvend punojnë 120 deputetë. 100 deputetë iu përkasin qytetarëve të kombit shqiptar. Kurse, 20 prej tyre iu përkasin komuniteteve jo shumicë si romë, ashkalinjë, egjiptianë, boshnjakë, turq dhe serbë.

Sot, ne në grup kemi pasur secili detyrat dhe përgjegjësitë tona. Ne i kemi kryer detyrat tona. E po ashtu, sikurse ne, edhe Kuvendi i ka funksionet apo detyrat e tij kryesore. Tri funksionet e Kuvendit janë: funksioni legjislativ, sepse i miraton ligjet, funksioni kontrollues sepse e kontrollon Qeverinë, si dhe funksion përfaqësues sepse na përfaqëson neve përmes deputetëve.

Të gjitha ligjet që miratohen në Kuvend kanë efekt në jetën tonë.

Prandaj, duhet ta dijmë se Kuvendi është një institucion që prek jetën tonë përmes ligjeve që miratohen në të, nga deputetët.



Autorët e këtij artikulli



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Pavarësia“
Klasa: V-2
Vendi: Prishtinë